



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

Kuvendi i Komunës

Nr. 02/42/19

Datë: 08.01.2020

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 pika d) dhe nenit 14 paragrafi 14.1 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008); nenit 10 paragrafi 10.2 dhe paragrafi 10.3 të Ligjit për Tokën Bujqësore (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 13/2007) dhe nenit 8 paragrafi 8.4 dhe neni 9 paragrafi 9.4 të Udhëzimit Administrativ për Ndërrimin e Destinimit të Tokës Bujqësore në Tokë Ndërtimore (U.A. Nr. 41/2006) dhe nenit 22 paragrafi 22.1 pika 4. të Statutit të Komunës së Junikut, **Kuvendi i Komunës së Junikut** në mbledhjen e rregullt të mbajtur më 27.12.2019, nxjerrë:

V E N D I M
Përfundimtar

Për shndërrimin e përhershëm të tokës bujqësore në tokë ndërtimore

- I. Me këtë vendim ndërrohet destinimi i tokës bujqësore në tokë ndërtimore.
- II. Parcelës kadastrale me numër P-73105038-02325-0 me sipërfaqe **2983 m²** (**dymijë nëntëqind e tetëdhjetë e tre metra katrorë**), zona kadastrale Junik me kulturë bujqësore / arë e klasës së II (dytë), vendi i quajtur "Berishe – Jazina" i ndërrohet destinimi i sipërfaqes prej **2983m²** nga shfrytëzimi aktual si tokë bujqësore në tokë ndërtimore.
- III. Parcelës kadastrale me numër P-73105038-02326-0 me sipërfaqe prej **4926 m²** (**katërmijë e nëntëqind e njëzetë e gjashtë metra katrorë**), zona kadastrale Junik me kulturë bujqësore / Livadh i klasës së II (dytë) në vendin e quajtur "Berishe – Jazina" i ndërrohet destinimi i sipërfaqes prej **4926 m²** nga shfrytëzimi aktual si tokë bujqësore në tokë ndërtimore.
- IV. Parcelat kadastrale nga pika II.dhe III e këtij vendimi pas nxjerrjes së vendimit përfundimtar duhet të evidentohen si toka ndërtimore në Planin Zhvillimor Komunal.

- V. Kompensimi për shndërrimin e tokës bujqësore në tokë ndërtimore sipas pikës I. të këtij vendimi do të paguhet në procedurë administrative me rastin e aplikimit për leje ndërtimi sipas kriterëve të parapara me nenin 14 paragrafi 14.2 pika a) të Udhëzimit Administrativ për Ndërrimin e Destinimit të Tokës Bujqësore (U.A. Nr. 41/2006).
- VI. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohen të gjitha dispozitat ligjore me anën e të cilave kjo fushë ka qenë e rregulluar.
- VII. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset kryetari i Komunës së Junikut respektivisht Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mjedis e Komunës së Junikut
- VIII. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen zyrtare të Komunës së Junikut.

Me këtë vendim njoftohen:

1. MAPL;
2. Kryetari i Komunës së Junikut;
3. Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mjedis;
4. Shërbimi i Kuvendit të Komunës së Junikut;
5. Pala, dhe
6. Arkivi i Komunës së Junikut.

Kryesuesi i Kuvendit
z. Muharrem Krasniqi

